

## SKEDA E GJYKIMIT NE TRE SHKALLE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga :

**Xhezair Zaganjori** - Kryesues  
**Evelina Qirjako** - Anëtar  
**Arjana Fullani** - Anëtar  
**Tom Ndreca** - Anëtar  
**Medi Bici** - Anëtar

në seancë gjyqësore, më datë **03.05.2017**, mori në shqyrtim çështjen administrative Nr. **378/2015**, që u përket palëve:

**Paditës:** Suez Maze

**I paditur:** Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë

**Objekti:** Detyrimin e palës së paditur për të më shlyer pagesën e ditëve të punës të papaguara që rrjedh nga puna e kryer për periudhat:

- 8 (tetë) muaj orë nate nga muaji Tetor 2007 deri në muajin Tetor 2008;
- Të gjitha festat zyrtare dhe ditët e shtuna për periudhën që kam shërbyer;
- Rritjen e pagës bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1061, datë 08.07.2010 për periudhën nga 1 Korrik 2010 deri më 04.01.2011;
- 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë pune dhe 10.6 (dhjetë pikë gjashtë) orë nate të papaguara që prej muajit Shtator 2010 deri më datën 04.01.2011.

**Baza ligjore:** Neni 32, 153, 154, 223, 224 të Kodit të Procedurës Civile. Neni 419, 420, 445, 450 të Kodit Civil. Neni 80, 81, 85, 86, 87 të Kodit të Punës. Ligji Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, neni 14/3.

Me Vendimin Nr. 70, datë 21.01.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur: “Të shpallë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për gjykimin e çështjes civile Nr. 21279-02341-23-2013/1545/330 Regjistri Themeltar, datë 19.12.2013 të paditësit Suez Mazi. Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.”.

Me Vendimin Nr. 212, datë 16.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e anës së paditur Insitutucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë t’i paguajë paditësit Sues Maze shumën 430957 Lekë.”.

Me Vendimin Nr. 4086, datë 06.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur: “- Prishjen e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër Nr. 212, datë 16.04.2014 dhe pushimin e gjykimin të çështjes.”.

### VENDOSI:

Prishjen e Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Nr. 4086, datë 06.11.2014 dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë por me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më datë 03.05.2017

Nr. 31003-00378-00-2015 i Regjistrimit Themeltar  
Nr. 00 - 2017 - 571 i Vendimit ( 337 )